



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

**FJALA E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL NË  
KOMISIONIN E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE**

*I nderuar Zoti Kryetar i Komisionit,*

*Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Deputetë,*

Kam nderin të raportoj përpara Jush, mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përgjatë vitit 2025, në përmbushje të detyrimit ligjor që ka institucioni, për të paraqitur situatën e zbatimit të ligjit në sistemin e shërbimit civil.

Fillimisht dëshiroj të vlerësoj faktin se ky Komision, në vijimësi, nuk është mjaftuar vetëm me dëgjimin e raportimit vjetor të Komisionerit, por përmes rezolutave dhe rekomandimeve, e ka mbështetur dhe i ka dhënë forcën e duhur ekzekutive vendimmarrjes së këtij institucioni.

Gjej rastin t'ju falënderoj, për gadishmërinë që keni treguar për të vlerësuar dhe mbështetur propozimet tona, në lidhje me plotësimin e mjeteve ligjore në dispozicion të Komisionerit, për një mbikëqyrje më efikase dhe në përputhje me zhvillimet e kohës.

Vëmëndja juaj e vazhdueshme ndaj zbatimit të Ligjit për Nëpunësin Civil, na jep sigurinë se integriteti i shërbimit civil mbetet një nga prioritetet kombëtare, që garantohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në hyrje të fjalës time, dëshiroj të evidentoj faktin se, viti 2025 ka shënuar konsolidim të metodologjisë së mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, për të kaluar nga një proces konstatues, drejt një mbikëqyrjeje proaktive dhe parandaluese, përmes monitorimit në kohë reale dhe rritjes së llogaridhënies së institucioneve të administratës publike që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil. Komisioneri ka synuar që të rrisë nivelin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, sidomos në drejtim të zbatimit të parimit të meritokracisë në rekrutime, respektimit të procedurave disiplinore, zbatimit të vendimeve gjyqësore, e aspekte të tjera të administrimit të shërbimit civil.

Një nga arritjet më domethënëse që ka nisur gjatë vitit që po raportojmë dhe po vijon të zhvillohet me prioritet gjatë vitit 2026, është edhe digjitalizimi i procesit të mbikëqyrjes. Ne po punojmë për

zhvillimin e një sistemi digjital, i cili do të sigurojë që çdo inspektim, çdo dosje dhe çdo vendimmarrje të jetë e gjurmueshme dhe transparente. Ky sistem nuk do të sjellë vetëm rritjen e efikasitetit të brendshëm të institucionit, por do të transformojë edhe mënyrën se si kontrollohet ligjshmëria në administratën publike, duke u mbështetur në standardet më të mira.

Vlerësimi juaj pozitiv për këto nisma të ndërmarra nga Komisioneri, të cilin e kemi marrë gjatë takimeve të përbashkëta, tregon se ndajmë të njëjtin vizion: një administratë publike transparente, llogaridhënëse dhe të mbrojtur nga subjektivizmi, përmes teknologjisë.

Këtë vit, raportimi i Komisionerit, përkon me një situatë nismash për ndryshime ligjore, nga ana e qeverisë, që përfshijnë nga njëra anë fushën e administrimit të shërbimit civil dhe nga ana tjetër riorganizimin e administratës vendore në aspektin territorial dhe të kompetencave.

Në këtë fazë që ndodhet procesi, Komisioneri vlerëson se duhet të tregohet një vëmendje e posaçme në drejtim të harmonizimit të këtyre ligjeve specifike, me qëllim që të krijohen përkufizime të qarta të nocioneve, kategorive, kompetencave dhe proceseve që aplikohen gjatë administrimit të shërbimit civil, në drejtim të standardizimit të tyre, si brenda tipologjisë së institucioneve vendore, ashtu edhe në gjithë sistemin e shërbimit civil. Komisioneri është i gatshëm për të ndihmuar në këtë proces.

Për të vazhduar më tej me raportimin për punët konkrete që janë realizuar gjatë këtij viti, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj se, Komisioneri ka vijuar me përkushtim zbatimin e kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Nëpunësin Civil, duke e shtrirë procesin e mbikëqyrjes në të gjitha tipologjitë e institucioneve që punësojnë nëpunës civilë.

Në prioritetet e veprimtarisë së tij janë përfshirë edhe detyrat e përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2024, të cilat janë në nivele të ndryshme zbatimi, sipas rrethanave dhe kërkesave specifike që ato përmbajnë.

Në raportin vjetor të paraqitur në Kuvend, Komisioneri është kujdesur që përmbajtja e tij të mos jetë thjesht një përmbledhje e disa shifrave administrative, por të përmbajë një analizë konkrete mbi qëndrueshmërinë, integritetin dhe profesionalizmin e shërbimit civil në tërësi.

➤ **Një nga veprimtaritë kryesore të Komisionerit përgjatë vitit 2025 ka qenë trajtimi i informacioneve/kërkesave/sinjalizimeve që kanë ardhur për shqyrtim në drejtim të institucionit.**

Për vitin e raportimit, referuar të dhënave të administruara, janë regjistruar në total **139** raste të informacioneve/ kërkesave, nga rezulton se, ka përfunduar procesi i inspektimit në **134** raste, që

përbëjnë rreth **96.4%** të rasteve të administruara, ndërsa vetëm **5** raste ose rreth **3.6%** janë të mbartura. Në momentin e raportimit ka përfunduar edhe trajtimi i tyre.

Numri i informacioneve të ardhura pranë Komisionerit paraqitet pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me vitin paraardhës, gjatë të cilit u regjistruan **145** kërkesa/informacione/denoncime. Ky tregues dëshmon një qëndrueshmëri në fluksin e adresimeve dhe një nivel të konsoliduar besimi nga ana e nëpunësve dhe institucioneve, të cilët i drejtohen Komisionerit për trajtimin e çështjeve që kërkojnë zgjidhje në kuadër të legjislacionit të shërbimit civil.

Nga tipologjia e rasteve, vihet re se marrëdhëniet individuale të punës së nëpunësve civilë përbëjnë mbi **86%** të çështjeve të trajtuara, të cilat kanë shërbyer edhe si indicie për nisjen, kryesisht, të proceseve të verifikimit dhe inspektimit administrativ. Në zbatim të kompetencave të Komisionerit dhe të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit, Komisioneri ka nisur kryesisht, inspektimin për **9** institucione të administratës publike, me fokus në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në disa institute të ligjit.

Për vitin e raportimit janë përmbyllur me vendim të Komisionerit **6** procese inspektimi dhe **3** procese janë mbartur për vitin 2026, pasi afati i përfundimit të tyre përkon me fillimin e vitit pasardhës, të cilat aktualisht kanë përfunduar.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ndonëse nuk ka për kompetencë direkte zgjidhjen e ankesave të nëpunësve civilë, bazuar në kompetencën e tij të parashikuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, për të ushtruar mbikëqyrje kryesisht, ose me kërkesë të institucioneve, ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e gjithë informacioneve, kërkesave apo denoncimeve të ndryshme, të ardhura në adresë të tij, duke i dhënë përgjigje konkrete shqetësimeve të ngritura nga subjektet e ligjit si edhe qytetarët, apo nëpërmjet vendimeve paralajmëruese drejtuar subjekteve të mbikëqyrura, për rregullimin e situatës ligjore.

Në vijim të kësaj analize, duke patur në vëmendje praktikën e institucionit, e cila rezulton efektive në këtë aspekt për të cilin po raportojmë, vlerësojmë se ka ardhur momenti të rishikohet veprimtaria e KMSHC –së, **duke i dhënë funksione të plota administrative, nëpërmjet trajtimit të ankesave të nëpunësve civilë** për çdo mosmarrëveshje që lind gjatë administrimit të marrëdhënies së punës në sistemin e shërbimit civil.

Kjo qasje do të sillte një ndryshim rrënjësor në dinamikën e trajtimit të ankesave administrative, duke sjellë një filtër paraprak profesional, të specializuar dhe të shpejtë, i cili do të lehtësonte ngarkesën e gjykatave dhe do të përmirësonte ndjeshëm ekzekutimin e vendimeve të tyre.

Ky propozim mbështetet në përvojën 11-vjeçare të KMSHC-së, gjatë së cilës është ndërtuar një praktikë e qëndrueshme dhe profesionale në trajtimin e çështjeve të shërbimit civil.

Nga analiza e vendimmarrjes së Komisionerit, është vërejtur përputhshmëri e plotë me vendimmarrjen e gjykatave administrative. Ky fakt është një tregues i qartë i saktësisë dhe besueshmërisë së vendimmarrjes së Komisionerit, ç'ka e mbështet më së miri propozimin, që vendimet e KMSHC-së të jenë të detyrueshme për tu zbatuar.

Kompetenca e shqyrtimit të ankesave nga ana e Komisionerit do të silltë uljen e ndjeshme të numrit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt rikthimin në punë të gjyqfituesve, apo aspekte të tjera që i përkasin instituteve të ndryshme të ligjit për nëpunësit civilë.

Po kështu, kjo kompetencë do të siguronte rivendosjen e ligjshmërisë në një kohë më të shkurtër, duke ulur ndjeshëm barrën ekonomike dhe administrative që vjen nga proceset e gjata gjyqësore, si për nëpunësit civilë, ashtu edhe për institucionet.

➤ **Ashtu si u evidentua edhe në fillim të kësaj fjale, Komisioneri ka patur në fokus të veprimtarisë së tij, monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së administrimit të shërbimit civil, në të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil.**

Procesi i mbikëqyrjes në kohë reale ose “*on line*”, ka qenë një nga proceset më të rëndësishme që është kryer në mënyrë të pandërprerë përgjatë gjithë vitit, me fokus nivelin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, duke përfshirë të tre tipologjitë e institucioneve, administratën shtetërore, administratën vendore dhe institucionet e pavarura.

Gjatë këtij procesi është komunikuar me **205** institucione dhe janë mbledhur të dhëna për **16.343** pozicione pune, ç'ka mundëson monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të ligjit dhe krijimin e një panorame të plotë të administrimit të sistemit të shërbimit civil.

Nga analiza e të dhënave rezulton përmirësim në drejtim të hartimit të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, megjithatë vijojnë të evidentohen mangësi, veçanërisht në nivel vendor, lidhur me emërimet në kundërshtim me ligjin dhe planifikimin e vendeve vakante gjatë administrimit të burimeve njerëzore.

Sipas strukturës organizative të institucioneve, janë evidentuar: **12976** pozicione pune të plotësuara në përputhje me kërkesat e ligjit; **1279** pozicione pune të plotësuara nëpërmjet akteve të emërimit, në kundërshtim me procedurat ligjore, ose **7.3%** e pozicioneve të punës në shërbimin civil dhe **2088** pozicione pune të paplotësuara. Përgjatë këtij viti janë evidentuar **1462** raste të emërimeve të reja, nga të cilat **33%**, e tyre përfaqësojnë mobilitetin e nëpunësve civilë dhe tregojnë zhvillim të mirë të karrierës së tyre brenda sistemit.

Në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, vihet re se, administrata vendore shënon numrin më të lartë të rasteve (**325**), e ndjekur nga administrata shtetërore (**278**) dhe institucionet e pavarura (**67**). Nga analiza e shkaqeve të aplikimit të këtij instituti të ligjit, rezulton

se profili i përfundimit të kësaj marrëdhënieje dominohet nga faktorë me natyrë vullnetare dhe demografike (*dorëheqje dhe pension pleqërie*), ndërkohë që shkaqet disiplinore (*largim nga shërbimi civil*) dhe ato organizative (*mbyllje apo ristrukturim*) shfaqen më të rralla. Në përgjithësi konstatohet një ulje e përgjithshme e fluksit të daljes nga sistemi, duke reflektuar një stabilizim të trupës së nëpunësve civilë.

Sa i përket aspektit të përfaqësimit gjinor, rezulton se burrat zënë **42.2%** të pozicioneve në shërbimin civil dhe gratë rreth **57.8%**, që tregon një trend pozitiv të përfaqësimit të grave në shërbimin civil. Ky proces është finalizuar me një raport vlerësimi i cili është publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit.

Mbikëqyrja në kohë reale, si një proces që ka shtrirje të gjerë në drejtim të numrit të pozicioneve të punës që mbulon në të gjithë sistemin e shërbimit civil, **ka nxjerrë në pah edhe disa sfida të rëndësishme operacionale**, gjatë veprimtarisë së Komisionerit, të cilat lidhen me:

- a) kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe logjistike të institucionit;
- b) nivelin jo të njëtrajtshëm të raportimit dhe njohurive ligjore nga ana e institucioneve që raportojnë pranë Komisionerit dhe,
- c) nevojën për standardizim të metodologjisë së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga subjektet.

Nisur nga përfundimet e arritura gjatë këtij procesi, Komisioneri vlerëson se mbikëqyrja në kohë reale duhet të konsolidohet më tej si një instrument strategjik për kontroll sistematik dhe parandalim, duke ofruar një bazë të fortë për analizë rrisht, planifikim të mbikëqyrjeve si dhe parandalim të parregullsisve. Ngritja e këtij procesi në nivele të tjera, kërkon investim të mëtejshëm në kapacitete, digjitalizim dhe standardizim të proceseve për të rritur efektivitetin e saj.

Për të arritur këtë qëllim, Komisioneri synon modernizimin e procesit të mbikëqyrjes “*on line*”, si një domosdoshmëri për të garantuar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, në një administratë që po digjitalizohet me shpejtësi.

**Nevoja për të kaluar në mbikëqyrje digjitale shfaqet në disa drejtime**, ndër të cilat vlerësojmë:

- a) rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë së proceseve që kryhen gjatë mbikëqyrjes;
- b) sigurimin e aksesit në sistemet aktuale të menaxhimit (*ndër të cilat edhe Rregjistrimi Qendror i Personelit dhe Platforma e – albania*);
- c) transparencën dhe objektivitetin e veprimtarisë;
- d) reduktimin e kostove administrative;
- e) aksesin në arkiva digjitale;
- f) përshtatjen me objektivin e integritetit të administratës publike në BE dhe

- g) mundësinë për ti njoftuar palëve vendimmarrjen e Komisionerit, nëpërmjet Platformës digjitale e-albania.

Modernizimi i mbikëqyrjes synon transformimin e rolit të Komisionerit nga një organ konstatues në një organ që e parandalon shkeljen përmes teknologjisë.

- **Një aspekt tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë së Komisionerit, është mbledhja e informacionit dhe mbështetja e institucioneve, gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.**

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën një tregues thelbësor të funksionimit të shtetit të së drejtës dhe të efektivitetit real të mbrojtjes juridike në administratën publike në tërësi dhe në shërbimin civil në veçanti, pasi lidhet drejtpërdrejt me stabilitetin e marrëdhënieve të shërbimit civil, sigurinë juridike dhe funksionimin normal të institucioneve që janë pjesë e shërbimit civil. Gjatë vitit raportues u monitorua procesi pranë **72** njësiteve të vetëqeverisjes vendore dhe rezultoi se **48** vendime gjyqësore janë ekzekutuar, duke reflektuar përpjekje institucionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore, ndërkohë që **96** vendime gjyqësore të formës së prerë rezultojnë të paekzekutuara, nga të cilat **87** prej tyre, kanë tejkaluar afatin njëvjeçar të konsideruar si afat i arsyeshëm për ekzekutim.

Nga analiza e rasteve, arrijmë në konkluzionin se shkaku kryesor i vonesave në ekzekutim lidhet me zgjatjen e proceseve gjyqësore administrative, e cila mesatarisht kalon mbi **4 vite**, ndërkohë që për çështjet e përfunduara pas vitit 2020, arrin në **5 vite**. Kjo situatë sjell pasoja negative në ekzekutimin e vendimeve, pasi gjatë kësaj periudhe, institucionet publike ndryshojnë strukturat organizative, plotësojnë pozicionet e lira me nëpunës të tjerë ose suprimojnë pozicione pune, çka e bën objektivisht të vështirë rikthimin efektiv të nëpunësit civil gjyqfitues në të njëjtin pozicion pune ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Duke marrë parasysh mungesën e një rregullimi të detajuar procedural në ligj, i cili të përcaktojë qartë afatet, proceset dhe përgjegjësitë konkrete të institucioneve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, Komisioneri vlerëson se përmirësimi i situatës kërkon ndërhyrje të qarta në planin normativ dhe institucional. Në këtë kuadër, propozojmë rishikimin e dispozitave të ligjit për shërbimin civil, si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore përmes të cilave të përcaktohen rregullime më të detajuara për procedurën e ekzekutimit, përfshirë mekanizmat e koordinimit për sistemimin efektiv të nëpunësve civilë gjyqfitues.

Ndodhur në këto rrethana, **Komisioneri propozon disa masa konkrete** që kërkojnë rishikimin e modelit aktual dhe të bazës ligjore në fuqi, që e rregullon këtë aspekt, duke synuar krijimin e një sistemi më efikas, në të cilin:

- a) të plotësohet kuadri ligjor me dispozita të detajuara që rregullojnë institutin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, përfshirë dhe përgjegjësitë konkrete të institucioneve;
- b) në ligj të parashikohet shprehimisht se, plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil të realizohet sipas një rendi përparësie që duhet të përfshijë të gjithë sistemin e shërbimit civil:
  - ✓ fillimisht nga lista e pritjes së nëpunësve civilë gjyqfitues, për të cilët është urdhëruar rikthimi në detyrë;
  - ✓ në mungesë të tyre, nga lista e nëpunësve civilë të pezulluar apo të rregjistruar në listën e pritjes pas konkurrimit;
  - ✓ dhe vetëm në rast se këto lista janë shteruar, të vijohet me procedurën e parashikuar nga ligji për plotësimin e pozicionit të shërbimit civil.
- c) të krijohen mekanizma të detyrueshëm të koordinimit ndërinstytucional, për të mundësuar sistemimin efektiv të nëpunësve civilë në rastet kur institucioni debitor nuk disponon pozicion të lirë;
- d) të miratohen akte nënligjore që të unifikojnë praktikën administrative që ka lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në të gjithë sistemin e shërbimit civil dhe të shmangin interpretimet e ndryshme të dispozitave ligjore, si edhe të përcaktohen subjektet që duhet ta zbatojnë atë;
- e) të parashikohen mekanizma për planifikimin dhe garantimin e fondeve të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga vendimet gjyqësore.

Komisioneri vlerëson se ndërhyrja në këtë drejtim, nuk përbën vetëm një përmirësim të kuadrit rregullator ekzistues, por edhe një rishikim të domosdoshëm të modelit të funksionimit të sistemit, me qëllim garantimin efektiv të zbatimit të vendimeve gjyqësore, uljen e kohëzgjatjes së proceseve dhe forcimin e sigurisë juridike në shërbimin civil.

Po kështu, analiza e situatës në këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, si edhe përvoja e Komisionerit në këtë drejtim, **tregon se rikthimi i një mekanizmi administrativ paraprak dhe i detyrueshëm për trajtimin e mosmarrëveshjeve në fushën e shërbimit civil**, përpara se palët ti drejtohen gjykatës, përbën një nga instrumentet më efektive për të ulur numrin e vendimeve gjyqësore dhe për të shkurtuar kohën e trajtimit të mosmarrëveshjes.

Përputhshmëria e lartë ndërmjet vendimmarrjes së Komisionerit dhe praktikës së gjykatave administrative, e cila është mbi **99%**, tregon se ky mekanizëm mund të jetë Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si institucioni që disponon kapacitetin dhe ekspertizën e nevojshme për të ushtruar një rol të tillë.

➤ **Ndërkohë, ka vijuar praktika e monitorimit të administrimit të shërbimit civil dhe sjelljes së nëpunësit civil, gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të 11 majit 2025**

Ky proces merr një rëndësi të veçantë, në kushtet kur periudha zgjedhore përbën një moment të ndjeshëm për administratën publike, për shkak të rritjes së rrezikut për ndërhyrje politike dhe cenim të paanësisë së nëpunësit civil. Në këto rrethana, administrata përballet me nevojën për të garantuar njëkohësisht vazhdimësinë e shërbimeve dhe ruajtjen e neutralitetit institucional. Në këtë kuadër, veprimtaria e Komisionerit gjatë periudhës 11 prill – 11 maj 2025, u orientua drejt një monitorimi të strukturuar, me fokus jo vetëm kontrollin e ligjshmërisë, por edhe parandalimin e rreziqeve të politizimit dhe ruajtjen e integritetit të shërbimit civil.

Në këtë proces, janë vendosur kontaktet me **200** institucione të administratës publike dhe janë përfshirë **13671** pozicione pune pjesë e shërbimit civil. Gjatë këtij procesi janë ngritur **200** Grupe Monitorimi ku janë përfshirë **705** nëpunës civilë. Këto trupa monitoruese kanë treguar një nivel të lartë bashkëpunimi dhe korrekte gjatë gjithë periudhës zgjedhore, në marrëdhënie me Komisionerin. Në kuadër të procesit të monitorimit, janë ushtruar inspektime ditore në terren në **59** subjekte, me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara nga Grupet e Monitorimit, si dhe për të evidentuar dhe adresuar probleme që kanë lindur gjatë kësaj periudhe në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

Nga të dhënat e administruara, janë evidentuar **4** raste, ku nëpunës civilë janë regjistruar si kandidatë për deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe **547** raste, ku nëpunës civilë kanë marrë pjesë në përbërje të komisioneve të administrimit zgjedhor. Për të gjitha këto raste Komisioneri ka verifikuar respektimin e kushteve të posaçme të kërkuara nga ligji për nëpunësin civil.

Komisioneri ka publikuar një udhëzues, me qëllim unifikimin e praktikave dhe sqarimin e dispozitave ligjore në situatat tipike të periudhës zgjedhore. Përmes këtij instrumenti u vendosën standarde të qarta për interpretimin dhe zbatimin e ligjit, duke reduktuar hapësirat për vendimmarrje subjektive.

### **Procesi është zhvilluar nëpërmjet:**

- a)**raportimeve ditore, nga institucionet për emërimet e reja në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, problematikat dhe prezencën në punë të nëpunësve civilë;
- b)**sondazheve dhe verifikimeve në terren të kryera nga Komisioneri dhe grupet e tij të mbikëqyrjes;
- c)**trajtimit të çdo informacioni apo denoncimi, përfshirë edhe ato të ardhura nga media apo subjekte të treta, për aspekte të ndryshme të administrimit të shërbimit civil.
- d)**Inspektimeve ditore në terren me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara nga Grupet e Monitorimit, si dhe për të evidentuar dhe adresuar probleme që kanë lindur gjatë kësaj periudhe në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

Gjatë kësaj periudhe është bashkërenduar puna edhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke kërkuar nga institucionet, që, në bashkëpunim me KQZ-në, të **standardizojnë autorizimet** që lejojnë nëpunësit civilë, apo edhe të gjithë nëpunësit e tjerë të administratës publike, për të marrë pjesë në administratën zgjedhore, duke parashikuar shprehimisht në to, detyrimet, përgjegjësitë administrative, civile dhe penale, sipas rastit, si edhe të drejtat që ata kanë, me qëllim që nëpunësi t'i njohë dhe t'i respektojë ato, duke ndikuar në këtë mënyrë që procesi zgjedhor të njohë rritje të integritetit dhe besueshmërisë së tij.

**Komisioneri ka mbikëqyrur zbatimin e standardeve, duke kërkuar nga institucionet përkatëse:**

- të ngrenë një sistem efektiv për rregjistrimin e kërkesë ankesave;
- të vendosin në efikasitet organet e disiplinës që janë eprori direkt dhe Komisioni Disiplinor;
- të organizohen trajnime të rregullta me nëpunësit civilë në lidhje me etikën në shërbimin civil dhe neutralitetin politik.

Në zbatim të këtyre rekomandimeve, **Departamenti i Administratës Publike** ka organizuar një sërë trajnimesh me nëpunës të institucioneve të tipologjive të ndryshme në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

Ky proces ka përfunduar me një raport analitik të posaçëm, i cili i është dërguar pranë Kuvendit, në zbatim të rezolutës për veprimtarinë e vitit 2024, ku theksohet fakti se tashmë është krijuar një praktikë e mirë pune në realizimin e procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore. Shërbimi civil ka vijuar të tregojë maturi në drejtim të zbatimit të parimit të paaanësisë politike, e po kështu i ka ardhur në ndihmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në rolin e anëtarëve të strukturave të posaçme të ngritura për të realizuar procesin zgjedhor.

Duke qene të interesuar e në mbështetje të një procesi zgjedhor në përputhje me ligjin, të gjitha palët e përfshira në proceset zgjedhore, të cilat ndihmojnë për të siguruar një proces me integritet e drejt standardeve më të mira të Hapësirës Evropiane, si;

- Komisionet Parlamentare;
- Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore, i ngritur në Kuvend dhe aktualisht si një aktor i rëndësishëm në procesin e rishikimit ligjor të paketës ligjore të zgjedhjeve;
- KQZ-ja;
- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- OSBE e ODIHR (*rekomandime në raportet e tyre të monitorimit për zgjedhjet në Shqipëri*);
- Organizatat e shoqërisë civile,

janë në kohë të organizojnë e të diskutojnë në një tryezë të përbashkët, për të gjetur mekanizma të reja si ligjore, ashtu edhe mbikëqyrjeje, për të ndikuar si në sjelljen e nëpunësve civilë, e po ashtu edhe në rritjen e efikasitetit të mbikëqyrjes që KMSHC-ja ushtron gjatë periudhës zgjedhore.

- **Edhe përgjatë vitit 2025, Komisioneri ka vijuar mbikëqyrjen në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strukturës organizative të institucioneve të vetëqeverisjes.**

Mbikëqyrja e procesit të hartimit dhe miratimit të strukturave organizative në njësitë e vetëqeverisjes vendore përbën një nga praktikatat e konsoliduara të Komisionerit, me synim garantimin e zbatimit të standardeve në administrimin e shërbimit civil në nivel vendor.

**Ky moment i administrimit të shërbimit civil paraqitet kompleks dhe i vështirë**, për shkak të mungesës së kapaciteteve të specializuara të burimeve njerëzore në shumë prej institucioneve vendore dhe mungesës së një strukture qendrore të dedikuar për menaxhimin e shërbimit civil, rol që në administratën shtetërore ushtrohet nga Departamenti i Administratës Publike. Në këto rrethana, Komisioneri ka ushtruar një rol aktiv mbështetës, duke ofruar asistencë teknike të vazhdueshme për institucionet e administratës vendore, duke i orientuar drejt përmirësimit të organizimit të brendshëm, përmes:

- a) riformulimit të funksioneve dhe objektivave;
- b) eliminimit të mbivendosjeve funksionale;
- c) forcimit të njësisë të burimeve njerëzore dhe,
- d) standardizimit të strukturave organizative në aspektin numerik.

Si rezultat i këtij angazhimi të vazhdueshëm, faza e vendosjes së standardeve numerike konsiderohet e përfunduar, duke reflektuar një nivel të qëndrueshëm përputhshmërie me praktikatat e administratës shtetërore. Në vijim, fokusi është zhvendosur drejt përmirësimit cilësor të strukturave, **veçanërisht në drejtim të identifikimit të saktë të pozicioneve** që përfshihen në shërbimin civil dhe **rritjes së cilësisë së përshkrimeve të punës**.

Në këtë kuadër, **Komisioneri ka miratuar dhe shpërndarë udhëzime specifike për institucionet vendore**, duke synuar harmonizimin e praktikave dhe përforcimin e zbatimit të kuadrit ligjor.

Për të sjellë strukturat organizative drejt standardeve më të mira, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjekte të tjera të ngarkuar prej ligjit me detyra specifike, që ti paraprijnë miratimit të strukturës organizative të institucionit me disa veprime administrative, ndër të cilat:

- a) vlerësimi i pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil nga Komiteti i Vlerësimit;
- b) hartimi dhe miratimi i formularëve të përshkrimit të punës nga eprori direkt dhe analisti i punës dhe,
- c) qartësimi i ndarjes së niveleve të strukturës që përfshijnë: pozicionet politike; nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë, në mënyrë që të realizohet shpërndarja e punonjësve sipas këtyre niveleve.

Rezulton se nga subjektet përkatëse është vepruar menjëherë sipas rekomandimeve të

Komisionerit **duke ngritur Komitetet e Vlerësimit në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.** Procesi i vlerësimit të pozicioneve ka përfunduar në disa raste, por ende nuk ka përfunduar në pjesën më të madhe të administratës vendore. **Ndër sfidat që hasen gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strukturës** në këtë tipologji institucionesh, mund të evidentojmë:

- a) kufizimet në buxhet;
- b) fryrje të strukturave, duke krijuar drejtori apo sektorë të panevojshëm;
- c) ndryshime të shpeshta të strukturës;
- d) mbivendosje të kompetencave midis pozicioneve të punës në strukturë;
- e) mungesa e matjes së performancës së institucionit;
- f) mungesa e infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme dhe,
- i) mungesa e burimeve njerëzore për shkak të lëvizjes demografike, e aspekte të tjera që çënojnë standardet në këtë rast.

Ndodhur në këto rrethana dhe referuar faktit që aktualisht, pranë Kuvendit funksion Komisioni i Posaçëm i Reformës Territoriale, **do të kërkonim edhe vëmendjen e këtij Komisioni** në analizat e tyre në ristrukturimin e hartës së ardhshme territoriale në drejtim të respektimit të skemës së administrimit të shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të eliminuar problematikat të cilat lidhen drejtpërdrejtë me shpërndarjen territoriale të NJQV-ve.

- **Sipas planit vjetor të institucionit, gjatë këtij viti, janë përfshirë në procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme dhe tematike 17 subjekte, të cilat kryesisht janë të tipologjisë së institucioneve të administratës vendore.**

Në këtë kuadër, janë zhvilluar **17** procese mbikëqyrjeje, nga të cilat **14** janë përmbyllur me vendime përfundimtare, ndërsa në **3** raste, proceset janë mbartur për vitin 2026 dhe janë përmbyllur në muajin janar të këtij viti. Mbikëqyrja ka qënë e drejtuar në procedurat e rekrutimit dhe në zbatimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil, si dy aspekte të rëndësishme për të njohur nivelin e zbatimit të ligjit, por edhe për shkak të problematikave që shfaqen gjatë aplikimit të tyre në praktikë.

Gjatë këtyre proceseve janë kontrolluar **1215** pozicione pune, ku **59%** rezultojnë të plotësuara në përputhje me ligjin, **11%** vakante dhe **30%** të plotësuara në kundërshtim me ligjin. Janë evidentuar gjithsej **374** raste të emërimeve në kundërshtim me procedurat dhe me parimet e ligjit për nëpunësin civil si: meritokracia, transparenca dhe profesionalizmi, duke ndikuar negativisht në funksionimin dhe integritetin e shërbimit civil.

Në përgjithësi, procedurat e konkurrimit rezultojnë të rregullta në rastet kur janë zbatuar, ndërsa **problematika kryesore** lidhet me *emërimet me kontratë* të përkohshme, si dhe me *mangësi në planifikimin, organizimin dhe dokumentimin e procedurave*.

Gjithashtu, janë konstatuar dobësi në funksionimin e organeve të konkurrimit dhe në respektimin e kërkesave të periudhës së provës. Një problematikë e përhapur mbetet mungesa e kandidatëve për të marrë pjesë në konkurrim, në disa bashki, kryesisht për shkak të faktorëve demografikë.

Në aspektin disiplinor, janë kontrolluar **33** masa disiplinore të aplikuara gjatë vitit 2025 në këto subjekte, të cilat rezultojnë kryesisht të natyrës së lehtë (“*vërejtje*”) dhe për disa raste është kërkuar rishikimi ose shfuqizimi i tyre, për shkak të mospërputhjes me kërkesat ligjore.

- **Një aspekt tjetër i rëndësishëm ku është orientuar veprimtaria e Komisionerit, është edhe mbikëqyrja në subjekt, e rekrutimeve të realizuara nga Departamenti i Administratës Publike.**

Ky proces është realizuar pranë DAP-it, përmes monitorimit të procedurave të konkurrimit për praninë në shërbim civil, në nivelin ekzekutiv, të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri ka rritur prezencën e tij gjatë procesit të zhvillimit të procedurave të konkurrimit, nga ana e DAP, përgjatë gjithë vitit kalendarik, duke i mbikëqyruar ato në vend, në kohë reale, në të gjitha fazat, për disa raste (**14** raste, për **25** pozicione pune, nga **8** raste, të zhvilluara një vit më parë) të përzgjedhura sipas tipologjisë së pozicioneve të shpallura për t'u plotësuar, të klasifikuara sipas kategorisë së pozicioneve në hierarkinë e shërbimit civil (*niveli ekzekutiv, niveli i ulët, i mesëm ose i lartë drejtues*), si edhe sipas tipologjisë së procedurës së aplikuar (*praninë në nivelin ekzekutiv; lëvizje paralele, apo ngritje në detyrë*).

Monitorimi i këtij procesi ka si synim të parandalohen shkeljet ligjore në pikëpamjen procedurale, si dhe të sigurohet një proces i drejtë dhe transparent konkurrimit.

Nga ana tjetër, Komisioneri ka trajtuar edhe **11** raste të informacioneve të ardhura në adresë të tij, nga nëpunës apo kandidatë që kanë marrë pjesë në proceset e konkurrimit të organizuara nga njësi përgjegjëse (DAP), pasi është pretenduar se janë kryer apo lejuar parregullsi gjatë zhvillimit të tyre. Në vlerësim të dokumentacionit të administruar në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar, si edhe shqyrtimit të informacioneve që kanë ardhur nga palë të interesuara, Komisioneri vlerëson se, procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë, i zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, është kryer në zbatim të procedurave të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit.

Komisioneri çmon se **është bërë një punë e mirë nga Departamenti i Administratës Publike**, sa i takon respektimit të procedurave që kryhen në zbatim të këtij procesi dhe vlerëson se duhet të orjentohej përpjekjet në drejtim të **rritjes së cilësisë së trupës së nëpunësve civilë të rekrutuar**, nëpërmjet ndërveprimit me qytetarët, me qëllim rritjen e numrit të konkurrentëve, duke publikuar

në portalin “online” të aplikimit, informacionet që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit dhe për t’i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e rritjes së nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura.

Nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike, **duhet të tregoj nivel më të lartë bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore**, sidomos *në drejtim të planifikimit të nevojave të tyre për rekrutim*, kjo me qëllim rritjen e efektivitetit në realizimin e procedurave të rekrutimit në përputhje me dispozitat ligjore dhe plotësimin të pozicioneve të lira, ç`ka është problematikë në këtë tipologji institucionesh. Kjo mbikëqyrje është finalizuar me një vendim përmbyllës dhe është publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit.

- **Ndërkohë, ka vijuar edhe përgjatë këtij viti, monitorimi në subjekt i rekrutimeve të realizuara nga Bashkia Tiranë**

Në të njëjtën linjë me mbikëqyrjen e procesit të rekrutimit në administratën shtetërore, me të njëjtin objekt dhe metodologji, është monitoruar edhe Bashkia e Tiranës, e përzgjedhur si një institucion me një numër të lartë të pozicioneve të punës që përfshihen në shërbimin civil. Në lidhje me këtë mbikëqyrje, janë monitoruar në subjekt **29** procedura konkurrimi, nga të cilat 20 janë përmbyllur me shpallje fituesi dhe 9 pa fitues.

Procedurat i përkasin kryesisht kategorisë ekzekutive, që përbën pjesën më të madhe të pozicioneve të planifikuara dhe në përfundim janë realizuar **69** emërimë, nga të cilat, 74% e rasteve, janë emëruar nga “*lista e kandidatëve të suksesshëm*”, në të cilën përfshihen kandidatët fitues të konkurrenive të zhvilluara më parë, që kanë marrë mbi 70% të pikëve totale të vlerësimit, për të cilët nuk është bërë i mundur emërimi i tyre në pozicione të shërbimit civil, duke reflektuar në këtë mënyrë një përdorim efikas të këtij mekanizmi ligjor.

Në përgjithësi, **procedurat janë zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk janë evidentuar ankesa nga kandidatët**. Ky proces është finalizuar me një vendim përfundimtar, ku është pasqyruar situata dhe akti është publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit.

- **Për herë të parë, gjatë këtij viti është aplikuar mbikëqyrja e procesit të zhvillimit të ecurisë disiplinore me kërkesë të organeve me kompetenca kontrolli të jashtëm ose të brendshëm, në institucionet e administratës shtetërore.**

Ky është një aspekt tjetër i veprimtarisë së Komisionerit, ku janë përfshirë **108** institucione dhe është konstatuar se vetëm në **12** (11%) prej tyre, janë administruar kërkesa për fillimin e procedimeve disiplinore, të cilat janë dërguar kryesisht nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave; Drejtoria e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion (DIBA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; Drejtoria e Kontrollit Tatimor (DKT), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Nga **67** shkelje të rekomanduara, **51** prej tyre janë shqyrtuar nga organet disiplinore, **ndërsa në 15** raste **Komisioneri ka konstatuar se në zbatim të gabuar të ligjit, nuk ka nisur ecuria disiplinore**, ndërkohë që në **1** rast, ende vijon procedura në subjekt. Konstatohet se një pjesë e masave disiplinore që janë dhënë me këtë motivacion, është kundërshtuar në gjykatat administrative dhe procesi vijon. Ky proces është finalizuar me një raport vlerësimi, i cili është bërë i njohur subjekteve të përfshira dhe është publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit.

➤ **Përgjatë vitit 2025, ka përfunduar procesi i monitorimit të strukturës dhe përbërjes së sistemit të shërbimit civil – Censusi 2024**

Komisioneri ndërmori gjatë vitit 2024 një proces mbikëqyrjeje të orientuar, i cili përbën një vlerësim gjithëpërfshirës të strukturës dhe përbërjes së shërbimit civil në nivel kombëtar. Ky proces, i konceptuar si një “census” i shërbimit civil, përfundoi përgjatë vitit 2025 dhe u zhvillua në përgjigje të konstatimeve të ekspertëve të Bashkimit Evropian mbi mungesën e të dhënave të plota dhe të sakta në administratën publike. Prosesi përfshiu **205** institucione dhe në përfundim u evidentuan **15,956** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat kategoria ekzekutive përbën 73% të totalit, niveli i ulët drejtues 16.9%, niveli i mesëm 8.2% dhe niveli i lartë drejtues vetëm 1.9%, duke konfirmuar një strukturë piramidale në përputhje me parimet e organizimit administrativ.

Sa i përket burimeve njerëzore, janë evidentuar **12,882** nëpunës civilë të emëruar në mënyrë të rregullt, të shpërndarë kryesisht në administratën shtetërore (52.2%), ndjekur nga njësitë e qeverisjes vendore (37.8%) dhe institucionet e pavarura (10%).

Analiza demografike tregoi se **gratë përbëjnë shumicën e nëpunësve civilë në të gjitha tipologjitë e institucioneve**, veçanërisht në nivelet ekzekutive dhe ato të ulëta drejtuese, ndërsa në nivelet e larta drejtimi vihet re një balancim më i madh gjinor.

Nga ana tjetër, **mosha mesatare e nëpunësve reflekton një administratë përgjithësisht të konsoliduar dhe me eksperiencë**, me diferenca të lehta ndërmjet niveleve qendrore dhe vendore. Ky proces është finalizuar me një raport vlerësimi i cili tashmë është publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit dhe është transparent për publikun.

➤ **Ka vijuar pjesëmarrja e Komisionerit në procese gjyqësore, në të gjitha rastet kur është thirrur nga gjykata si palë në pozita të ndryshme procedurale.**

Nga praktika e këtij viti, rezulton se vendimet e Komisionerit nuk janë kundërshtuar në asnjë rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjykatë. Megjithatë, një pjesë e këtyre vendimeve janë vënë në shqyrtim gjyqësor në kuadër të mosmarrëveshjeve të paraqitura ndërmjet nëpunësve civilë dhe institucioneve publike.

Gjatë këtij viti, Komisioneri ka marrë pjesë në **19** procese gjyqësore të zhvilluara pranë gjykatave administrative të shkallës së parë ku është thirrur në cilësinë e palës së tretë. Në këto raste, **qëndrimi i mbajtur nga gjykatat ka qenë në të njëjtën linjë me vlerësimin dhe interpretimin ligjor të dhënë më parë nga Komisioneri**, duke konfirmuar kështu qëndrueshmërinë dhe saktësinë juridike të vendimmarrjes së institucionit.

Pranë gjykatave të niveleve më të larta, janë në shqyrtim **74** procese administrative, për të cilat institucioni ka ushtruar ndjekje të vazhdueshme procedurale. Ky volum procesesh evidenton kompleksitetin e çështjeve që lidhen me shërbimin civil dhe rolin aktiv të Komisionerit në ndjekjen e tyre në të gjitha shkallët e gjykimit.

➤ **Ndjekja e rekomandimeve të Kuvendit me qëllim përmbushjen e zbatimit të tyre, ka qënë një ndër detyrat prioritare të Komisionerit.**

Në rezolutën “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024*”, Kuvendi i Shqipërisë ka përcaktuar një sërë rekomandimesh për vitin 2025, të fokusuara në forcimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes.

Megjithëse rezoluta është miratuar në muajin nëntor 2025, Komisioneri e ka orientuar në mënyrë proaktive veprimtarinë e tij drejt përmbushjes së këtyre rekomandimeve, përmes hartimit të një plani veprimi dhe ndërmarrjes së masave konkrete për përmirësimin e proceseve të brendshme dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Gjatë vitit 2025 është **shënuar progres i dukshëm në zbatimin e detyrave** të lëna nga Kuvendi. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përmbushur plotësisht, ndërsa të tjerat janë në proces zhvillimi, kryesisht për shkak të kompleksitetit teknik dhe nevojës për bashkëpunim ndërinstitutional.

Në drejtim të mbikëqyrjes, **janë intensifikuar inspektimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore**, duke u fokusuar në institucionet me histori shkeljesh të përsëritura. Po ashtu, **është realizuar monitorimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore** për rikthimin në detyrë në njësitë e qeverisjes vendore, si dhe **është ofruar asistencë teknike për një numër të konsiderueshëm institucionesh**, duke kontribuar në rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së këtyre vendimeve.

Një arritje e rëndësishme për vitin 2025 është edhe **hartimi dhe dorëzimi pranë Kuvendit i raportit mbi sjelljen e nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore**, bazuar në një proces monitorimi të gjerë që ka përfshirë rreth 200 institucione dhe mbi 13,600 pozicione pune.

Paralelisht, institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë **drejt digjitalizimit dhe modernizimit të proceseve të tij**, përfshirë zhvillimin e platformave për raportim dhe ankim, si dhe konceptimin e

mekanizmave për monitorim në kohë reale. Këto iniciativa janë në fazë zhvillimi dhe pritet të konsolidohen më tej gjatë vitit 2026, në bashkëpunim me institucione të tjera përgjegjëse. Në të njëjtën linjë, ka filluar puna për hartimin e raporteve analitike mbi institucionet me shkelje të përsëritura, si dhe mbi kostot financiare që rrjedhin nga vendimet e paekzekutuara.

➤ **Procesi i ndjekjes së zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, është një aspekt që finalizon procesin e mbikëqyrjes.**

Verifikimi i zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të paralajmërimit, është realizuar për **39 vendime** paralajmëruese të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, inspektimit apo hetimit administrativ.

Në një këndvështrim krahasues me një vit më parë, evidentohet një rënie e lehtë e rasteve në të cilat procesi i zbatimit të vendimeve paralajmëruese është përmbyllur me vendim përfundimtar të Komisionerit, nga 71% në vitin 2024 në 67% në vitin 2025.

Kjo lidhet kryesisht, me kompleksitetin e problematikave të trajtuara si dhe me faktin që ky është një proces që shpesh kërkon një kohë relativisht të gjatë deri në përfundimin e tij, duke marrë parasysh **sfidat që paraqiten**, si në drejtim të vullnetit për t'u zbatuar nga zyrtarët e ngarkuar me detyra specifike, ashtu edhe në drejtim të vështirësisë që haset gjatë implementimit të zbatimit të ligjit, nga subjektet e tij.

Ky proces kërkon një ndjekje dhe impenjim të vazhdueshëm nga ana e Komisionerit, pasi nuk është thjesht një rutinë verifikimi, por **nevojitet pothuajse në të gjitha rastet**, ndërgjegjësimi i subjekteve dhe asistenca teknike që nevojitet për realizimin e një procedure të caktuar, për të rregulluar pasojat e shkeljes së konstatuar, në të gjitha fazat që duhet të kalojë procesi që do të realizohet (*konkurrim, transferim, ecuri disiplinore, pezullim, e institute të tjera të ligjit*).

Praktika ka treguar se institucionet, shpesh deklarojnë informacione të pasakta ose të cunguara në lidhje me detyrat e realizuara në përfundim të afatit të paralajmërimit, çka domosdoshmërisht kërkon verifikimin e tyre në subjekt nga ana e Komisionerit.

Nga ana tjetër, **për shkak të dinamikës së lartë të veprimeve** që kryhen gjatë administrimit të shërbimit civil, pasi çdo ditë dalin akte të reja emërimi, transferimi, vlerësimi, ristrukturimi, etj., ndodh që në momentin e verifikimit të zbatimit të vendimit paralajmërues, të evidentohet një situatë tjetër nga ajo e konstatuar në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, duke e lënë të hapur mundësinë për t'u ndodhur në kushtet e inkoherencës së vendimit paralajmërues të Komisionerit me situatën konkrete pas verifikimit të zbatimit të tij.

Ndodhur në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se ka ardhur momenti për ndryshim të kuadrit ligjor, me synim forcimin e efektivitetit të mjeteve që janë vendosur në dispozicion të Komisionerit për rregullimin e paligjshmërisë.

**Konkretisht, propozohet** që vendimet e Komisionerit të mos kenë më karakter paralajmërues apo rekomandues, por të përcaktohet shprehimisht në ligj se ato janë akte administrative me fuqi detyruese për institucionet subjekt i ligjit, duke imponuar zbatimin e menjëhershëm të tyre.

Njëkohësisht, në përputhje me parimet e së drejtës administrative, duhet të sanksionohet se këto vendime mund t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor nga institucionet e interesuara, pa cenuar detyrimin për zbatim të menjëhershëm, përveç rasteve kur gjykata disponon ndryshe.

➤ **Në planin e veprimeve të Komisionerit për vitin 2026, janë parashikuar edhe drejtimet strategjike në funksion të realizimit të kompetencave të tij.**

Një nga prioritetet kryesore në veprimtarinë e Komisionerit për vitin 2026, do të jetë **zhvillimi i mekanizmave të mbikëqyrjes në kohë reale**, nëpërmjet **digjitalizimit** të proceseve dhe përdorimit të **platformave analitike** që mundësojnë identifikimin e hershëm të problematikave dhe orientimin e inspektimeve drejt institucioneve me risk më të lartë për shkelje të ligjit.

Aktualisht, institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë drejt digjitalizimit dhe modernizimit të proceseve të tij, ku përfshihet zhvillimi i platformave për raportim dhe ankim, si dhe konceptimin e mekanizmave për monitorim në kohë reale.

Në të njëjtën linjë me detyrat e përcaktuara në rezolutën e Kuvendit, ka filluar puna për hartimin e raporteve analitike mbi institucionet me shkelje të përsëritura, si dhe mbi kostot financiare që rrjedhin nga vendimet e paekzekutuara.

Ndërkohë, po punohet nga njëra anë për të forcuar kapacitetet profesionale të stafit të Komisionerit dhe nga ana tjetër për të zhvilluar metodologjinë e mbikëqyrjes, me synim rritjen e nivelit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese.

Një fokus i veçantë do t'i kushtohet standardizimit të praktikave në administrimin e burimeve njerëzore, përmirësimit të klasifikimit të pozicioneve të punës në sistemin e shërbimit civil, si dhe ndjekjes së zbatimit të vendimeve gjyqësore, në mënyrë që të shmangen kostot financiare për buxhetin e shtetit dhe të rritet përgjegjshmëria administrative.

Finalizimi i nismës së qeverisë, për ndryshime në Ligjin për Nëpunësin Civil me miratimin e saj nga ligjvënësi, do të sjellë nisjen e menjëhershme të punës në drejtim të:

- rishikimit të të gjithë akteve rregullatore të veprimtarisë së Komisionerit;
- hartimit të startegjisë së re dhe të planit të veprimit të institucionit të Komisionerit.

Duke e mbyllur fjalën time, i nderuar Kryetar, dëshiroj të rikonfirmoj edhe njëherë se roli monitorues i këtij Komisioni, është për ne një shtysë e vazhdueshme për të rritur standardet tona. Ju falënderoj për mbështetjen që na keni dhënë dhe që do ta kemi më të nevojshme në të ardhmen, në adresimin e sfidave që na presin në procesin e integritimit evropian.

Faleminderit,

*Me respekt*  
**KOMISIONERI**

**Lefterije Lleshi (Luzi)**